

20151163460

L I G J
PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR VEPRIMTARI TURISTIKE

Neni 1

Në Ligjin për veprimtari turistike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 62/2004, 89/2008, 12/2009, 17/11, 47/11, 53/11, 123/12, 164/13 dhe 27/14) neni 52 ndryshohet si vijon:

"Lloje tjera të shërbimeve turistike në kuptim të këtij ligji konsiderohen:

- organizimi i aktiviteteve rekreative dhe argëtuese në plazhe dhe pishina,
- huazimi i objekteve lundruese për argëtim (sandolina, dërrasë për lundrim dhe ngjashëm), mjete për ski në ujë, biçikletë, karrige për shtrirje dhe ombrellë për mbrojtje nga dielli, mjete për peshkim dhe ngjashëm dhe
- veprimtari shërbyese lidhur me transportin ujor të cilat realizohen me objekt lundrues me fuqi të motorit që nuk i tejkalon 20 kuaj fuqi dhe i cili përfshin transport të maksimum 12 personave.

Për dhënien e shërbimit nga paragrafi 1 i këtij neni, dhënësi i shërbimit është i detyruar t'i sigurojë shfrytëzuesit shërbime të sigurimit nga lëndimi apo vdekja.

Shërbimin nga paragrafi 1 i këtij neni, mund ta japin persona fizikë.

Dhënësi i shërbimit nga paragrafi 1 i këtij neni është i detyruar që pajisjen dhe mjetet që ia jep shfrytëzuesit, përkatësisht pajisjen me të cilën kryhet veprimtaria shërbyese lidhur me transportin ujor, t'i mirëmbajë ashtu që të jenë të sigurta për shfrytëzim."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".